

WE ARE YOUR DOL

NEW YORK STATE

Department of Labor

PAGA MINIMALE E SHITIT TË NJU JORKUT

SI PUNËTOR, SA ËSHTË PAGA IME MINIMALE?

Nga 1/1/2024 deri më 31/12/2024, paga bazë minimale e Shteti të Nju Jorkut është:

- \$16.00 në orë në Qytetin e Nju Jorkut.
- \$16.00 në orë në Long Island dhe kontenë Westchester
- \$15.00 në orë në Pjesën tjetër të Shtetit të Nju Jorkut

Dhe paga minimale për punojnës të fast food-eve* është:

- \$16.00 në orë në të gjithë Qytetin e Nju Jorkut, Long Island dhe kontenë Westchester
- \$15.00 në orë pjesën tjetër të Shtetit të Nju Jorkut

Punonjësit e sektorit privat në shtet, duke përfshirë punëtorët shtëpiakë (në më të shumtën), duhet të marrin pagën minimale bazë.

RRETHANA TË VEÇANTA

Norma bazë mund të ndryshojë sipas rregullave të njohura si "urdhurat e pagave" që përcaktojnë pagën minimale për punë në:

- Industrinë e mikpritjes, shërbimeve të ndërtimit dhe bujqësisë
- Të gjitha industrinë dhe vendet e tjera të punës

Urdhurat e pagave përcaktojnë:

- Normat për orë
- Normat jashtë orarit
- Kredi për ushqim dhe akomodim, nëse mundësohen nga punëdhënësi

Urdhri i pagës për sektorin e Mikpritjes përcakton norma më të ulëta të pagës minimale për orë nëse punëtorët marrin rregullisht bakshish. Urdhurat e pagave janë të pasqyruara në faqen e internetit të Departamentit të Punës: www.labor.ny.gov/minimumwage.

Kur punëtorët i mundësojnë vetë uniformat e kërkuara për pozicionin e punës, atyre duhet t'u paguhet një shumë e shtuar mbi pagën minimale.

Punonjësit, puna e të cilëve nuk është me orë po me sasi produkti, duhet të paguhet me një normë që i afrohet të paktën pagës minimale bazë.

Një javë pune standarde është 40 orë: Nëse punonjësit punojnë çdo orë përtej kësaj, atëherë punëdhënësi duhet t'i paguajë ata me 1½ herë më shumë se paga e zakonshme.

SI PUNËDHËNËS, SI TË PËRMBUSH TË GJITHA ASPEKTET E LIGJIT PËR PAGESË MINIMALE?

Departamenti i Punës ndihmon në mbledhjen e pagave të prapambetura për punëtorët që nuk kanë marrë pagën minimale. Punëdhënësit që shkelin ligjin për pagën minimale mund t'i nënshtrohen detyrimit për të paguar:

- Pagat e prapambetura
- Interesat
- Dëmet e likuiduara
- Gjoha

Ata gjithashtu mund t'i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimeve. Gjohat për shkelje mund të arrijnë deri në 200 për qind të pagave që mungojnë. Ata gjithashtu mund të duhet të paguajnë 16 për qind interes për pagat e papaguara.

Punëdhënësit duhet të vendosin një poster për Pagën Minimale në vendin e tyre të biznesit, ku punëtorët të mund ta shohin atë.

Punëdhënësit me pyetje ose shqetësime në lidhje me respektimin e Ligjit të Pagës Minimale mund të kontaktojnë Departamentin e Punës në **888-469-7365** për ndihmë, nga ora 08:00 deri në orën 17:00, nga e hëna deri të premten.

*Një punonjës fast food-i është çdo person i punësuar ose i lejuar të punojë në, ose për, një ndërmarrje të fast food-eve, nga çdo punëdhënësi ku detyrat e punës përfshijnë të paktën një nga sa vijon: shërbimin ndaj klientit, gatimin, përgatitjen e ushqimit ose pijeve, shpërndarjen, sigurinë, ruajtjen e furnizimeve ose pajisjeve, pastrimin ose mirëmbajtjen rutinë.

Departamenti i Punës i Shtetit të Nju Jorkut është një Punëdhënësi/Program me Mundësi të Barabarta. Ndhmësit dhe shërbimet ndihmëse janë në dispozicion sipas kërkesës dhe pa pagesë për individët me aftësi ndryshe TTY/TDD 711 ose 1-800-662-1220 (Anglisht) / 1-877-662-4886.